



Prishtinë: 30.10.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1067_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1860_09_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **12.10.2018**.

në seancën e mbajtur më datë 30.10.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A. S. nga fshati Shkabaj, Prishtinë, me shifër të konsumatorit: DPR - 90040490, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1860_09_19** i datës 17.09.2018.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 04.09.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se fatura e muajit 06/2013 është në rregull dhe e bazuar në procesverbalin e qendrës së kalibrimit. Në ankesë është theksuar se analiza e DMK rreth krahasimit të shpenzimeve nuk mund të merren si të sakta, pasi me njehsor të ndryshëm ka shpenzim të ndryshëm. Në ankesë është theksuar se pretendimi se fatura 06/2013 nuk paraqet shpenzim real mujor nuk është i saktë pasi që sipas procesverbalit të kalibrimit njehsori është brenda kufijve të lejuar. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1860_09_19 i datës 17.09.2018 për konsumatorin A. S. me shifër DPR - 90040490.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 30.10.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se fatura e muajit 06/2013 është në rregull dhe e bazuar në procesverbalin e qendrës së kalibrimit, Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë shqyrtimit të lëndëve të konsumatorit nuk mund të merret për bazë vetëm procesverbali i kalibrimit si procesverbal meritor pa u shqyrtuar edhe dëshmitë tjera. Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë analizës së



bërë shkresave të lëndës, e posaçërisht të procesverbalit të inspektimit nr.0528468 të datës 20.11.2013 ka evidentuar se edhe përkundër se shpenzimet e konsumatorit të evidentuara në CCP për periudhën tetor 2013 përputhen me gjendjen e evidentuar në procesverbalin e inspektimit, në procesverbal gjithashtu është theksuar që konsumatori dyshon se njehsori elektrik nr.47442702 nuk bënë matje të saktë, andaj i njëjti të dërgohet për shqyrtim në laboratorin e kalibrimit.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se analiza e DMK rreth krahasimit të shpenzimeve nuk mund të merren si të sakta, pasi me njehsor të ndryshëm ka shpenzim të ndryshëm, Bordi i ZRRE-së thekson se kjo nuk qëndron, pasi që krahasimi i shpenzimeve është një indikator mjaft i rëndësishëm në analizimin dhe shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve. Bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve të energjisë elektrike, si dhe konsum të ulët të energjisë. Bordi i ZRRE ka bërë krahasimin e shpenzimeve për periudhën kontestuese me periudhat e njëjta të më hershme dhe të mëvonshme me dy njehsorët elektrik, njehsorin kontestues nr.47442702 si dhe njehsorin e ri elektrik nr.73446224, dhe ka vërejtur se shpenzimi i konsumatorit për periudhat e më hershme me njehsorin elektrik nr.47442702: periudha 06/2011 është **584 kWh**, periudha 06/2012 është **608 kWh**, periudha 06/2013 është **4,162 kWh**, kurse për periudha të mëvonshme me njehsorin e ri elektrik nr.73446224: periudha 06/2014 është **652 kWh**, 06/2015 është **579 kWh**, periudha 06/2016 është **369 kWh**, periudha 06/2017 është **370 kWh**, si dhe periudha 06/2018 është **374 kWh**. Bordi i ZRRE thekson se bazuar në analizat e bëra konstaton se konsumatori në periudhën kontestuese 06/2013 nuk është faturuar me shpenzimet reale për shkak se shpenzimet e më hershme, si dhe të mëvonshme me njehsorët elektrik nr.47442702 dhe nr.73446224 vërteton se konsumatori ka shpenzim më shumë të ulët dhe se këto shpenzime nuk përputhen me shpenzimet e faturuara për periudhën 06/2013.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se pretendimi i organi të shkallës së fatura 06/2013 nuk paraqet shpenzim real mujor nuk është i saktë, Bordi i ZRRE-së thekson se konstatimi i organit të shkallës së parë është i saktë dhe kjo bazuar në analizën e rrjedhës së energjisë elektrik me dy njehsorët elektrik, njehsorin kontestues nr.47442702 si dhe njehsorin e ri elektrik nr.73446224, ku është vërejtur se shpenzimet e faturuar me njehsorin elektrik nr.47442702 për periudhën 06/2013 nuk paraqesin shpenzime reale mujor të konsumatorit, pasi që siç u theksua edhe më lartë shpenzimet para dhe pas periudhës kontestuese nuk përputhen me shpenzimet e faturuara për periudhën 06/2013. Andaj Bordi i ZRRE konstaton se vendimi i organit të shkallës së parë në të cilën është theksuar se KESCO duhet t'i anuloi konsumatorit me shifër DPR – 90040490 faturën nr.06130DPR-90040490 të datës 04.07.2013 në vlerë 298.76€ dhe se për këtë periudhë duhet të faturohet me shpenzimet e faturuara në periudhën 06/2014.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 30.10.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit A. S. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.